



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE SHKODËR

NOTER VASIL MARTINI  
ADRESA Rr. Luigj Gurakuqi, Nr 2 ,  
Lezhe  
TEL: 0682049692

# KONTRATË DHURIMI PASURI E LUAJTSHME (KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 736

Nr. koleksioni: 408

Lezhe më 17/02/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

\*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2022043370041760151



A2022043370041760151

## KONTRATË DHURIMI KUOTASH KAPITALI

Sot, më datë 17.02.2022, para meje Noter VASIL MARTINI, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore SHKODËR, me zyrë në adresën Lezhe, Rr. Luigj Gurakuqi, Nr 2, Lezhe, u paraqit personalisht:

### DHURUES:

**1-Shoqëria LEON GROUP INVEST**, regjistruar si person juridik në QKB me numër unik identifikimi të subjektit NUIS L98602504L, me adresë Lagjja 'besëlidhja', Rruga 'kosova', Pallati 13 Katësh, Kati I I Banimit., përfaqësuar nga ortaku **Elona Ndrecaj**, atësia Mark, amësia Davida, shtetase Shqiptare, lindur në FushëArrëz, Pukë dhe banuese në TIRANË, me adresë Hajdar Hidi; Nd. 29; H. 9; Ap. 8; Njësia Bashkiake Nr. 10; 1001; Tiranë, lindur më 23/01/1982, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 037696433 dhe nr. personal I251231370. përfaqësuar nga **Ortaku Florian Ndrecaj**, atësia Gjin, amësia Pashke, shtetas Shqiptar, lindur në Lezhë dhe banues në TIRANË, me adresë Hajdar Hidi; Nd. 29; H. 9; Ap. 8; Njësia Bashkiake Nr. 10; 1001; Tiranë, lindur më 10/08/1981, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036560295 dhe nr. personal I10810222D. dhe (Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "**Dhuruesi**")

### PRANUES I DHURIMIT:

**1-Elona Ndrecaj**, atësia Mark, amësia Davida, shtetase Shqiptare, lindur në FushëArrëz, Pukë dhe banuese në TIRANË, me adresë Hajdar Hidi; Nd. 29; H. 9; Ap. 8; Njësia Administrative Nr. 10; Njësia Bashkiake Nr. 10; 1001; Tiranë, lindur më 23/01/1982, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 037696433 dhe nr. personal I251231370, (Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "**Përfituesi i dhurimit**")

### I. IDENTIFIKIMI I PALËVE

Identiteti i personave fizikë palë në kontratë si edhe zotësia e tyre për të vepruar u identifikua mbështetur në dokumentet e identifikimit të paraqitura nga vetë personat fizikë, si edhe në prezencën fizike të seicilit. Seicili nga palët e ka zotësinë juridike dhe për të vepruar.

Nëpërmjet Ekstraktit të Gjendjes së Rregjistrimit, lëshuar nga QKB, u verifikua gjendja e rregjistrimit të shoqërisë "Leon Group Invest" shpk dhe u konstatua se shoqëria është shoqëri aktive. Pala e pare është ortak në shoqëri dhe deklaroi se Shoqëria është aktive, nuk është në proces falimentimi, nuk është në ndjekje penale, nuk është nën sekuestro apo nën forma të tjera të kufizimit të zotësisë së saj juridike dhe e lire për qarkullim civil të pjeseve të kapitalit të saj.

Personat si më sipër identifikuar, me vullnet të lirë dhe të plotë, me kërkesë të shprehur seicili personalisht, të informuar e në dijeni të pasojave ligjore në rast deklarimi të pavertete, hartuan këtë akt.

### II. BAZA LIGJORE

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, më posaçërisht nenet 659 e vijues të tij;
- Kodi i Familjes, Ligji Nr.9062, date 8.5.2003, më posaçërisht nenet 73-76 të tij;
- Ligji Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", më posaçërisht nenet 72-75 të tij;
- Ligji për Noterine Nr.110/2018 "Për Noterine".

### III. RRETHANA PARAPRAKE

- a. Shoqëria "Leon Group Invest" shpk është regjistruar si person juridik shqiptar me përgjegjësi të kufizuar, e identifikuar me numër NUIS: L 98602504 L, ka status aktiv, nuk evidentohen barresime e



A2022043370041760151

- marrveshje kufizuese mbi pjeset e kapitalit te shoqërisë. Palët deklarojnë se nuk ka të tilla.
- b. Pala e Parë, si më sipër është bashkëpronar në Shoqërinë “Big Shengjini” dhe “Big Tale” shpk, të zotëruar nga ortakët:
1. **Shoqëria “BIGALB GROUP”:** Numri pjeseve 1 (një);  
Pjesëmarrja në përqindje: 51,00 %;
  2. **Leon Group Invest:** Numri pjeseve 1 (një);  
Pjesëmarrja në përqindje: 49,00 %;
- c. Pala e Parë **Leon Group Invest**, ku ortakë janë **Elona NDRECAJ** dhe **Florian NDRECAJ**, ku keta dy të fundit janë bashkëshort, në rregjimin pasuror martesor në bashkësi dhe deklarojnë se Pasuria objekt material i kësaj kontratë, e rregjistruar në emër të subjektit të lartpërmendur (**Leon Group Invest**) është krijuar përgjate martesës dhe është pasuri nën regjimin pasuror martesor të bashkësisë ligjore.
- d. Shoqëria “Big Shengjini” dhe “Big Tale” shpk dhe ortakë Shoqëria “BIGALB GROUP” me Vendimet Nr 01 datë 17.02.2022 dhe Nr 02. datë 17.02.2022 në menyrë të shprehur kanë dhënë aprovimin e tyre për tjetërsimin e kuotave.

### OBJEKTI I KONTRATËS

Objekti i kësaj kontrate është:

- Kalimi pa kundërshpërbllim me dhurim, prej Palës së Parë **Leon Group Invest** të kuotave që kjo shoqëri ka në Shoqërinë Big Shengjini shpk në masën 49% ose një kuote, si dhe të kuotave që **Leon Group Invest** ka në Shoqërinë Big Tale në masën 49% ose një kuote tek Pala e Dytë **Elona NDRECAJ**, i një pjese, të barabartë me 49,00 % nga Pjesa prej 49,00 % që **Leon Group Invest** shpk zoteron në shoqëri.

### DEKLARIME TË PALËVE

- Pala e Parë **Leon Group Invest**, e përbërë nga ortakët, **Elona NDRECAJ** dhe **Florian NDRECAJ** deklaron se me dëshirë të shprehur, me vullnet të lire e të plote i kalon pa kundërshpërbllim Palës së Dytë **Elona NDRECAJ** (Një) pjese, të barabartë me 49,00 % nga Pjesa prej 49,00 % që **Leon Group Invest** zoteron në shoqëri.
- Pala e Dytë **Elona NDRECAJ** me dëshirë të shprehur, me vullnet të lire e të plote deklaron se është dakord për kalimin e pjesës së kapitalit në emrin e saj.
- Palët deklarojnë se transferimi pa kundërshpërbllim i pjesës në kapital bëhet në zbatim të Kodit të Familjes, Ligji Nr.9062, datë 8.5.2003, më posaçërisht nenet 74 i që përcakton se “*Bashkësia përbëhet nga: a) pasuria e fituar nga të dy bashkëshortët, se bashku ose veç e veç, gjate martesës;...*” dhe Neni 76 “*Pasuria e bashkëshortëve prezumohet si e përbashkët, me përjashtim të rastit kur bashkëshorti provon karakterin e saj vetjak.*”

### GJËNDJA E PRONËSISË PAS KALIMIT

Me nënshkrimin e kësaj kontrate Pala e Parë **Leon Group Invest**, humbet të drejtën e pronësisë mbi pjesën e kapitalit që ajo ka zotëruar në Shoqëritë Big Shengjini dhe Big Tale dhe transferohet dhe Pala e Dytë **Elona NDRECAJ** që bëhet pronare i Një (1) kuote, të barabartë me 49,00 % të kapitalit të shoqërisë BIG shengjini shpk, gjithashtu bëhet pronare e një kuote të barabartë me 49% të kapitalit themelor të Shoqërisë Big Tale shpk.

Me rregjistrimin në QKB të kësaj kontrate Shoqëria “Big Shengjini” dhe “Big Tale” shpk, do të zotërohet nga ortakët në raportet si më poshtë:

1. **Shoqëria “BIGALB GROUP”:** Numri pjeseve 1 (një);  
Pjesëmarrja në përqindje: 51,00 % (pesëdhjet e një për qind);
2. **Elona NDRECAJ:** Numri pjeseve 1 (një);  
Pjesëmarrja në përqindje: 49,00 % (dyzet e nente për qind);



A2022043370041760151

Palet depozitojnë dhe kerkojne që kontrates ti bashkengjiten dhe të jene pjese integrale te saj edhe:

- Ekstrakt i Regjistrimit Tregetar te Shoqerise "Big Shengjini" dhe "Big Tale" shpk.
- Vendim Nr 01 dhe Nr 02 datë 17.02.2022 i Shoqerise "Big Shengjini" dhe "Big Tale" shpk
- Çertifikata Familjare
- Dokumentacioni i identifikimit te paleve.

Ky akt përpilohet ne katër kopje. Kopje te aktit ruhen nga palët dhe depozitohen pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për tu pasqyruar ndryshimi i pronësisë së shoqërisë sipas detyrimeve ligjore.

Kopjes se aktit qe arshivohet ne zyren time noteriale i bashkangjiten imazhet e printuara marre gjate nenshkrimimit te aktit.

Sa më sipër me kerkesë të shprehur të palëve përpilohet kjo Kontratë tjetërsim kuotash, e cila ju lexua palëve me zë. Palët deklarojnë se e gjejnë tërësisht, e paragraf për paragraf në perputhje me vullnetin e tyre të lirë, të plotë e të pavesuar, japin pëlqimin e tyre për gjithçka më sipër dhe e nënshkruan aktin rregullisht duke vendosur emer mbiemer dhe firmë.

**PALA E PARË**

**Leon Group Invest**  
NUIS: L 98602504 L  
Perfaqesuar nga  
Florian Ndrecaj

*Florian Ndrecaj*  
*[Signature]*

Elona Ndrecaj

*Elona Ndrecaj*  
*[Signature]*



**PALA E DYTË**

**Elona NDRECAJ**

*Elona Ndrecaj*  
*[Signature]*

**NOTER**  
**VASIL MARTINI**

*[Signature]*